

GJYKATA SUPREME E Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve: H. , M., V.1, V.2, S. dhe A. O., të gjithë nga ..., dhe N. , S., A.1, A.2, E., F., A.3, H. dhe V. T., nga ..., të cilët i përfaqëson F.C.-M., avokate nga ..., kundër të paditurve: NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a. në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson Gani Haxhijaj dhe NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë, për shpërblimin e dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur përkitazi revizionit e të paditurës NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.761/2015 datë 30.7.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.1.2019, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishtëm të revizionit e të paditurës NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.761/2015 datë 30.7.2018, dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.209/09 datë 19.11.2014 vetëm sa i përket kamatës në shumën e gjykuar, ashtu që në këtë shumë paditësve u gjykohet kamata të cilën e paguajnë bankat vendore për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit, pa destinim të caktuar, duke filluar nga data 19.11.2014 e gjer në pagesën definitive, gjersa në pjesën tjetër revizioni i të paditurës refuzohet si i pabazuar.

## A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.209/09 datë 19.11.2014, nën paragrafin I të dispozitivit pjesërisht aprovohet kërkesëpadia e paditësve H., M., V.1, V.2, S. dhe A. O., të gjithë ..., dhe N., S.1, A.1, A.1, E., F., A., H. dhe V. T., nga ...,dhe detyrohen të paditurat NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a. në Fushë

Kosovë dhe NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë që solidarisht paditësve në emër të dëmit të pësuar jomaterial dhe material tu paguajë shumat si vijon: 1.H. O. 1a) të dëmit jomaterial: në emër të dhimbjeve trupore fizike shumën prej 7.000 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 18.200 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4.900 €, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 7.000 €; b) të dëmit material në emër të përkujdesjes së personit të tretë për periudhën e kaluar nga data 24.8.2008 e deri më datën 31.10.2014 shumën prej 3.899 €, në emër të rentës për periudhën nga data 1.11.2014 e tutje gjersa të ekzistojnë kushtet ligjore nga 52.50 € në muaj, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 105 €.c) anëtarëve të familjes së paditësit H. O., paditësve M. O., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të bashkëshortit të saj H. O., shumën prej 2.450 €. Paditësit V. O.1., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të babait të tij H. O., shumën prej 1.750 €. Paditëses V. O.2. , në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të babait të saj paditësit H. O., shumën prej 1.750 €. Paditëses S. O., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të babait të saj paditësit H. O., shumën prej 1.750 €. Paditëses A.O., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të birit të saj paditësit H. O., shumën prej 2.100 €.

2. N. T.,: a) të dëmit jo material: në emër të dhimbjeve trupore fizike shumën prej 8.760 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumën prej 11.200 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 4.900 €, në emër të shëmtimit trupor shumën prej 5.600 €. b) të dëmit material: në emër të përkujdesjes së personit të tretë shumën prej 350 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 154 €. c) familjes së N. T.,: paditëses S. T., bashkëshortes së paditësit N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të bashkëshortit të saj, shumën prej 2.100 €, paditësit E. T. , të birit të N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të tij N. T., shumën prej 1.750 €, paditëses A. T., të bijës së N. T.1, në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €, A. T.2, të bijës së N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €, F. T., e bija e N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €, A. T.3, e bija e N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €, V. T., babai i paditësit N.T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €, H. T., nëna e N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të dhimbjeve të pësuar të babait të saj, shumën prej 1.750 €. Të

gjitha këto shuma të miratuara si nën pikën 1 a,b dhe 2.a,b të dispozitivit të këtij aktgjykimi, të paditurat detyrohen që paditësve t'ua paguajnë me kamatë ligjore prej 3,5%, të cilën e aplikojnë bankat si në mjetet e afatizuara , pa destinim caktuar kthimi mbi një vit, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi 19.12.2014 e deri te pagesa definitive si dhe tu kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 5.160 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh , nga dita e marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Nën par. II të dispozitivit, kërkesëpadia e paditësve H. , M., V.1, V.2, S., A. O., Naim , S., E., A.1, A.2, F., A., V. dhe H. T., e cila ka të bëjë për kërkesën për kompensim në shumën më të lartë se sa shuma e aprovuar si nën pikën 1 a,b dhe 2 a,b të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për paditësin H. O., në emër të dhimbjeve trupore fizike prej 7.000 € deri në 11.300 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 18200 deri në 32000, në emër të frikës së përjetuar 4.900 € deri në 7.000 €, në emër të shëmtimit trupor prej 7.000 € deri në 1.000 €, në emër të ndihmës dhe përkujdesit të personit të huaj prej 3.899 € deri në 55.70,77 € prej datës 24.8.2018 e deri në 31.10.2014, prej 3899 deri në 5570.77 € në emër të rentës prej 52.50 € gjer në 75 €, në emër të ushqimit të përforcuar prej 105 deri në 150 €, për paditësen M. O., në emër të dhimbjeve shpirtërore prej 2100 në 35.000 €, për paditësit: V.1, V.2 , S. O., në emër të dhimbjeve shpirtërore prej 1750 € deri në 2500 €, A. O., në emër të dhimbjeve shpirtërore prej 2100 € deri në 3000 €, paditësit N. T., në emër të dhimbjeve trupore fizike prej 8760 € deri në 1770 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 1200 € deri në 22000 €, në emër të frikës së përjetuar prej 4900 € deri në 800 €, në emër të shëmtimit trupor prej 5600 € deri në 9500 €, në emër të përkujdesit të personit të tretë prej 350 € deri në 500 €, në emër të ushqimit të përforcuar prej 154 € deri në 400 €, paditëses S. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimit të bashkëshortit të saj N. T. prej 2100 € deri në 3000 € dhe paditësve: E., A.1, A.2 T., F. , A., në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të lëndimeve të pësuar të babait të tyre, prej 1750 € deri në 2500 €, V. T., babai i N. T. dhe H. T., nëna e N. T., në emër të dhimbjeve shpirtërore për lëndimit e djalit të tyre N. T. prej 1750 € deri në 2500 € si dhe kërkesa e paditësve që të paditurat dëmin e pësuar tu kompensojnë me kamatë ligjore prej 3.5% nga dita e ushtrimit të padisë të datës 31.8.2009 e deri më 20.12.2012 dhe nga data 20.12.2012 e deri në pagesën definitive, sipas normës së kamatës ndëshkuese ligjore prej 8% si dhe kërkesëpadia e paditësve e cila ka të bëjë me kompensimin e shpenzimeve të procedurës në shumën më të lartë se shuma e aprovuar, refuzohet si e pabazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.761/2015 datë 30.7.2018, nën pikën I të dispozitivit aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e të autorizuarës së paditësve: H., M., V.1, V.2, S. dhe A. O., të gjithë nga ..., dhe N., S., A.1, A.2, E., F., A., H. dhe V. T., nga ..., dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.209/09 datë 19.11.2014, në pjesën e dispozitivit lidhur me shpenzimet e procedurës, ashtu që gjykohet: detyrohen të paditurat që në mënyrë solidare paditësve tu paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 5390 €. Nën pikën II të dispozitivit, aprovohen pjesërisht të bazuara ankesat e të paditurave: NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a. në Fushë Kosovë dhe NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, C.nr.209/09 datë 19.11.2014, në pjesën e dispozitivit lidhur me dëmin jo material për dhimbjet fizike për paditësin N. T., ashtu që gjykohet: detyrohen të paditurat që paditësit në mënyrë solidare t’i paguajnë në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 7500 € ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar refuzohet si e pabazuar. Nën pikën III të dispozitivit, aprovohen pjesërisht të bazuara ankesat e të paditurave : NP Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “Infrakos” sh.a. në Fushë Kosovë dhe NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë dhe ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë- Dega në Glllogoc, C.nr.209/09 datë 19.11.2014, për paditësit: A.1, A.2, E., F., A., H. dhe V. T. nga ..., në pjesën e kërkesëpadisë përkitazi me kompensimin për shkak të dhimbjeve shpirtërore për invaliditet dhe shëmtimin e familjarit të tyre N. T., ashtu që gjykohet: detyrohen të paditurat që secilit paditës të cekur në këtë pikë të dispozitivit, në mënyrë solidare tu paguajnë shumat prej nga 1500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë përtej shumës së gjykuar, refuzohet si e pabazuar. Nën pikën IV të dispozitivit, refuzohen pjesërisht të pabazuara ankesat e të autorizuarës së paditësve dhe ankesat e të paditurave, ndërsa aktgjykimi i atakuar C.nr.209/09 i datës 19.11.2014 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Glllogoc, në pjesën tjetër të dispozitivit (përfshirë edhe pjesën e korrigjuar të aktgjykimit sipas aktvendimit C.nr.209/09 datë 30.1.2015), vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, në afatin ligjor ka paraqitur revizion e paditura NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “Trainkos” sh.a. në Fushë Kosovë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni dhe të prishen të dy aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda të kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 215 të LPK, gjeti se:

Revizioni është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me datë 24.8.2008 ka ndodhur aksidenti hekurudhor në linjën fushë Kosovë-Pejë, në fshatin Çikatovë e vjetër, Komuna e Glllogocit nga treni nr. 52312 i cili po tërhiqte vagonat e mbushur me zhavorr në drejtim të Fushë Kosovës të cilin me shpejtësi të madhe e ngiste makinisti H. S., punëtor i të paditurës së dytë, me ç'rast katër vagonat, vagoni i parë, dytë, tretë dhe i pestë rrëshqasin nga binarët me ç'rast punëtorët, tani paditësit H. O., dhe N. T., të cilët kanë qenë të hipur në vagon pësojnë lëndime të rënda trupore, dhe si pasojë e këtyre lëndimeve, paditësi H. e amputon dorën, ndërsa paditësi N. e humb në tërësi thembrën e këmbës së majtë e po ashtu të njëjtit pësojnë edhe lëndime tjera trupore. Paditësit H. O. dhe N. T. kanë qenë në marrëdhënie të përhershme pune tek te e paditura si punëtorë me kualifikim profesional në mirëmbajtjen e linjave hekurudhore, ndërsa tani punëtorë të paditurës së parë. Në kohën kur ka ndodhur aksidenti si subjekt ka funksionuar Kompania e hekurudhave të Kosovës sh.a. e cila më vonë me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 05/2010 të datës 26.2.2010 është bërë ndarja e hekurudhave të Kosovës në dy kompani të pavarura dhe atë: sh.a. për Menaxhimin, mirëmbajtjen dhe ndërtimin e infrastrukturës së hekurudhave dhe në Menaxhimin, operimin dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave me hekurudhë dhe me mjete tjera të transportit përkatësisht në "Infrakos" dhe në "Trainkos" në rastin konkret të paditurat. Komisioni hetues i të paditurave ka hartuar raportin me datë 2.9.2008 dhe ka konstatuar se me datën 24.8.2008, rreth orës 8:30 minuta në kilometrin 18+740 nga treni 51312, i cili ka bartur zhavorr, kanë rrëshqitur nga binarët dhe janë rrotulluar vagoni 2,3 dhe 4 nga lokomotiva ndërsa vetëm kanë rrëshqitur nga binari vagoni i 5 dhe 6 me radhë, nga rrëshqitja e këtyre punëtorët A. G., H. O., N. T. kanë pësuar lëndime të rënda, gjersa lëndime të lehta trupore kanë pësuar H. G., L. T. e F. O., punëtorë të Hekurudhave të Kosovës, të cilët kanë qenë në këta vagona duke përgatitur për shkarkim të gurëve nga vagonët në brezin hekurudhor. Sipas komisionit hetues shpejtësi matësi i trenit ka qenë i blombuar, ndërsa pas nxjerrjes së shiritit mbi lëvizjen e shpejtësisë është konstatuar se në momentin e rrëshqitjes së vagonëve, treni ka lëvizur me shpejtësi prej 62 km/h. Komisioni hetues në raportin e tij ka konstatuar se i njëjti tren ka tejkalar shpejtësinë, e po ashtu është konstatuar se në të njëjtën periudhë të shkurtër kohore te trenat e balastit nga i njëjti makinist shpeshherë është tejkalar shpejtësia maksimale. Po i njëjti

komision hetues i të paditurave ndër të tjerash ka konstatuar se përgjegjës për ndodhjen e aksidentit të datës 24.8.2008, janë përgjegjës direkt I. Sh., shef i njësisë së mirëmbajtjes së linjave hekurudhore në Klinë, sepse iu ka urdhëruar punëtorëve të hipin në platformë të vagonëve në ditën kritike e për këtë nuk ka qenë i njoftuar drejtuesi i trenave e as makinisti, ndërsa shefi i njësisë së mirëmbajtjes të linjave hekurudhore në Klinë, nuk e ka përcjellë shpejtësinë e trenit edhe pse ka qenë në kabinë me makinistin dhe nuk ka reaguar kur treni e ka tejkaluar shpejtësinë dhe ka pranuar të jetë udhëheqës i punëtorëve për shkarkim të balastit në segmentin hekurudhor të cilin nuk e njeh. Përgjegjësi tjetër H. S. makinist i cili e ka tejkaluar shpejtësinë e lejuar për lëvizjen e trenit, po ashtu përgjegjës direkt është edhe S. S., shef i njësisë për MLH në Fushë Kosovë ngase nuk i ka kryer kontrollimet e rregullta të linjave hekurudhore siç parashihen me Rregulloren 314. Komisioni hetues ka vlerësuar se përgjegjësi indirekte të paditurat mbajnë ngase M. B. , udhëheqës i trenit-ndihmës makinist, i cili nuk ka qëndruar në kabinën e parë me makinistin edhe pse ka qenë i obliguar ta përcjellë shpejtësinë e trenit dhe nuk ka reaguar kur ka vërejtur punëtorët e vendosur në platformë të vagonëve. Pastaj, B. S. drejtues i trenave në stacionin Drenas po ashtu nuk ka reaguar dhe nuk ka njoftuar personelin e trenit, për zvogëlimin e shpejtësisë në vendin e shkarkimit. A. M. , teknolog në tërheqjen e trenave në Fushë Kosovë ka përgjegjësi indirekte edhe pse ka konstatuar se makinisti H. S. e tejkalon shpesh herë shpejtësinë maksimale të lejuar, asnjëherë nuk ka njoftuar kompetentët për një gjë të tillë. I. S., shef i shërbimit për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore i cili nuk ka hartuar asnjë plan të veprimit apo udhëzimit përkatës kështu që edhe shefat e njësive që kanë qenë udhëheqës në shkarkim, nuk e kanë ditur vendin e saktë të shkarkimit. N. R., menaxher i sektorit për mirëmbajtjen e linjave hekurudhore nuk ka vepruar sipas Rregullores 314 edhe pse i është sugjeruar që të ulë shpejtësinë e trenave , atë e ka kundërshtuar me motivacion se gjendja e linjave hekurudhore është e mirë. Së fundi N. K. , drejtor i Divizionit të Infrastrukturës pasi që edhe pse ka qenë në njohuri se kontrollat sipas Rregullores 314 , nuk janë kryer , nuk ka kërkuar përgjegjësi nga varësit e tij. Personave të cilët kanë pasur përgjegjësi direkte, Komisioni disiplinor i të paditurave iu ka shqiptuar masën disiplinore të largimit nga Hekurudhat e Kosovës. Ndaj makinistit të trenit është paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Publike Komunale në Prishtinë për veprën penale shkaktim i rrezikut të përgjithshëm.

Në bazë të konstatimit dhe mendimit me shkrim të ekspertit të komunikacionit hekurudhor Fadil Rexhepi të datës 11.3.2013, konstatohet se ditën kritike kur kanë pësuar

lëndime paditësit , treni ka lëvizur në drejtim të vijës hekurudhore Drenas-Bardh i nisur nga Stacioni i trenit në Drenas nga binari i pestë, shpejtësia e trenit me nr. 52312 ka qenë 62 km/h e lexuar në shpejtësi matësin në vendin e aksidentit në kilometrin 18+740 në vijën hekurudhore Drenas-Bardh, në fshatin Çikatovë e Vjetër. Sipas ekspertit shpejtësia e lejuar në këtë pjesë është 60 km/h. Personeli i trenit nuk ka qenë i informuar në formë zyrtare për punën të cilën duhet të kryhej. Punëtorët , tani paditësit, kanë qenë në platformat e vagonëve që është në kundërshtim me nenin 5 dhe 32 të Rregullores nr. 2. Shefi i Njesisë për MLH I. Sh. ka urdhëruar të sistemohen punëtorët në platforma të vagonëve në kundërshtim me rregulloret pozitive të hekurudhave sepse punëtorët vendosen në platformë vetëm si manipulues për zbrazjen e balastit kur treni qarkullon me shpejtësi prej 5 km /h e që parashihet me nenin 35 të Rregullores nr. 2 si dhe Udhëzimit 42 neni 251. Pastaj treni nuk është pajisur me orar të manovrës dhe as me urdhëresë të përgjithshme nr. 1 e shumë të meta të tjera të cilat eksperti i ka përshkruar në mendimin e tij profesional ku ia vlen të theksohet edhe fakti se shpejtësia e trenit sipas nenit 35 të rregullores nr. 2 për këtë lloj lëvizje është caktuar të jetë 25 km/h. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit nga lëmi i mbrojtjes dhe sigurisë në punë Doc.dr.ing. H. N. i dhënë me datë 11.4.2013 është konstatuar se paditësit N. O. dhe H.T. kanë qenë të aftësuar nga lëmi i sigurisë në punë ndërsa lejimi i tyre nga ana e punëdhënësit tani të paditurve për vendosjen dhe qëndrimin e punëtorëve në platformë të vagonëve, në vijën e hapur hekurudhore , është në kundërshtim me obligimet dhe përgjegjësitë e punëdhënësit të cilat rezultojnë nga dispozitat e nenit 2.2., 2.4 dhe 2.7 të Ligjit nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit e të punësuarve dhe ambientit të punës. Sipas këtij eksperti paditësit nuk kanë guxuar të hipin në platformë, ndërsa sipas ligjit ata menjëherë është dashur ti njoftojnë punëdhënësit e tyre se qëndrimi në platformë të vagonëve paraqet rrezik për shëndet dhe jetën e tyre dhe kanë pasur të drejtë që këtë qëndrim të tyre ta refuzojnë, prandaj edhe sipas këtij eksperti përgjegjësia primare për këtë aksident ekziston te punëdhënësi gjersa tek paditësit ekziston përgjegjësi sekondare në proporcion 70:30.

Për masat dhe llojin e lëndimeve të paditësit N. O. dhe N.T. është vërtetuar nga dokumentacioni mjekësor dhe mendimit të ekspertëve Dr. Sami Deliu-ortoped dhe traumatolog dhe Dr. N. M. – psikiatër. Sipas mendimit të ekspertëve, paditësi H. O. ka pësuar lëndime trupore amputim të regjionit të parakrahut të anës së majtë me defekte të mëdha të indeve të buta nënlëkurore , muskujve dhe lëkurës. Lëndime të tilla trupore, ekspertët i kualifikojnë si lëndime

të rënda trupore. Në ekspertizën e tyre janë përshkruar dhimbjet fizike të përjetuara , intensiteti si dhe kohëzgjatja e tyre. Nga këto lëndime paditësi H. O. ka zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor 65%, ndërsa zvogëlimi i aktivitetit punës i përhershëm në shkallë prej 50%, pastaj shëmtim trupor i shkallës së rëndë për shkak të mungesës së dorës etj. Njëherit, paditësi N. T. sipas mendimit të ekspertëve ka pasur thyerje të shumëfishta të kockës së thembrës në anën e majtë të shoqëruara me defekt traumatik i cili në të njëjtën ditë ka qenë dashtë të operohet ku është fiksuar me dy shufra metalike. Sipas mendimit të ekspertëve pos formave tjera të dëmit i njëjti ka përjetuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 35% ndërsa zvogëlimi i aktivitetit të punës i përhershëm në masën 25%.

Nga kjo gjendje faktike, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se për aksidentin e shkaktuar në të cilin paditësit H. O. dhe N. T. kanë pësuar lëndime të rënda trupore , kanë përgjegjësi të ndarë. Të paditurat lëshimet e të cilave janë primare dhe paditësit lëshimet e të cilëve janë sekondare në përpjesëtim me 70:30 % duke u bazuar edhe në mendimin e ekspertit nga lëmi i mbrojtjes dhe siguri në punë dhe në bazë të kësaj shkalle të përgjegjësisë, i obligon të paditurat që paditësve t'ua paguajë, në emër të dëmit material dhe jomaterial shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore pjesërisht ka pranuar ankesën e të paditurave dhe të autorizuarës së paditësve dhe ka vendosur më afërsisht të përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit të goditur me revizion.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë në gjendjen faktike të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur pjesërisht ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë së të paditurave dhe të paditësve H. O. dhe N. T.j në shkaktimin e dëmit. Aktgjykimi i goditur me revizion nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara thëniet e revizionit të paditurës NP Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës, “Trainkos” sh.a. fushë Kosovë, se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni



182.2 (n) të LPK-së, se dispozitivi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, është në kundërthënie me arsyetimin etj. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë , i kuptueshëm dhe nuk është në kundërshtim me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit. Po ashtu, është i pabazuar pretendimi i të paditurës se aktgjykimi i goditur me revizion është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore që janë bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë. Kjo për arsye se sipas dispozitës së nenit 204 të LPK-së, është paraparë se në arsyetimin e aktgjykimit gjegjësisht aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj. Në rastin konkret, gjykata ankimore në arsyetimin e aktgjykimit të saj ka pranuar në tërësi arsyet për faktet relevante të gjykatës së shkallës së parë si të drejta dhe të ligjshme me përjashtim vetëm të lartësisë së gjykuar, për arsye se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban arsye të plota dhe të mjaftuara për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë parashtruar në ankesë, prandaj pretendimet e revizionit në këtë drejtim kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara ngase arsyetimi i aktgjykimit i gjykatës së shkallës së dytë duhet të paraqesë përgjigje në arsye të ankesës e të cilat janë të mjaftueshme kur u referohet arsyeve të gjykatës së shkallës së parë të cilat i ka çmuar si të drejta, sikurse drejt ka vepruar në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë, përndryshe përsëritja e arsyeve nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë do të ishte e panevojshme. Njëherit është irrelevant dhe i pabazuar pretendimi në revizion se gjykata me rastin e përcaktimit të shumave të gjykuara nuk ka pasur parasysh se e paditura në mënyra të ndryshme u ka ndihmuar paditësve në ofrimin e mjeteve monetare për përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore dhe ndihmave tjera, kjo për arsye se pala paditëse, sa i përket kompensimit të shpenzimeve të shërimit, nuk ka pasur kërkesë e nga ana tjetër këto pretendime nuk kishin me ndikuar në marrjen e çfarëdo vendimi tjetër më të favorshëm për të paditurën.

Për sa i përket shumave të gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me dëmin jomaterial dhe material për paditësit, drejt janë aplikuar dispozitat e LMD e lidhur me nenin 322 të LPK-së duke pasur parasysh konstatimet dhe mendimet e ekspertëve mjekësorë, lëndimet e pësuar, natyrën , peshën, intensitetin, etj., e posaçërisht përgjegjësinë e ndarë në bazë të kontributit 70:30%. Prandaj, duke pasur parasysh këto kritere shumë e caktuara nga gjykata e shkallës së dytë përkitazi me llojet e sipërcekura të dëmit jomaterial dhe material, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë reale dhe në përputhje me kriteret e parapara ligjore si dhe në

harmoni me praktikën gjyqësore. Nga lartë të cekurat, pretendimet e të paditurës në revizion lidhur me lartësinë e shumave të gjykuara, kjo Gjykatë i vlerëson si të pathemelta.

Gjykata Supreme duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare lidhur me aplikimin e gabuar të së drejtës materiale gjeti se kamata e aprovuar në shumën e gjykuar është zbatuar jo në mënyrë të drejtë në kuptim me dispozitën e nenit 277 të LMD-së ngase kjo kamatë nuk është caktuar në përputhshmëri me këtë dispozitë ligjore, pasi që kamata e pranuar në lartësi prej 3.5% nuk është e thënë se të jetë e njëjtë në të gjitha bankat vendore. Andaj, duke u nisur nga fakti se lidhur me kamatën e aprovuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të dytë është marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, të njëjtit në këtë pjesë u ndryshuan e në bazë të dispozitës së nenit 224 par. 1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e dispozitës së nenit 222 dhe 224 par. 1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr.385/2018 datë 14.1.2019

Kryetari i kolegjit,

Isa Kelmendi